



Pranuar / Dorezuar Puniheno / Prifato Received / Delivery	23.12.2020	viti god year	0
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	3269/2020		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.414/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtar, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.414/2020 të datës 14.12.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë rruga "Sefedin Vitia", pa numër në Prishtinë, kundër Vendimit me numër 1523 të datës 01.10.2020 të Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, në çështjen juridike "pezullim nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 23.12.2020, mori këtë

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.414/2020 e datës 14.12.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr.1523/2020 i datës 01.10.2020 i Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.
- III. OBLIGOHET Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin [REDACTED] në pozitën Kryeshf Ekzekutiv ne Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës sipas Vendimit me Nr.04/89 të datës 12.02.2019 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e 50% të pagës nga dita e pezullimit deri në zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

A r s y e t i m

Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit më datë 01.10.2020, ka nxjerr vendim me numër 1523/2020 me të cilin e ka pezulluar nga detyra me 50% të pagës ankuesin [REDAKTUAR] Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, po ashtu me datë 01.10.2020 ka dorëzuar shkresën-kërkesën me numër protokoll 1524/2020 për Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit z. [REDAKTUAR] për shkak të shkeljeve të rënda të detyrës zyrtare.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.1523/2020 të datës 01.10.2020 të Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.10.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2008/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.11.2020 ka nxjerr Vendim A.nr.288/2020 me të cilin është obliguar Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të shqyrtoj lëndën e datës 01.10.2020 të parashtruar nga Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Megë Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë nuk e ka shqyrtuar lëndën, atëherë ankuesi Ilir Morina më datë 14.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3107/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin për nxjerrje të vendimit meritor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 14.12.2020 me numër protokoll 3107/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.288/2020 i datës 20.11.2020 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Mendim Mospajtues i datës 20.11.2020; Ankesën e datës 07.10.2020 me numër protokoll 2008/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 1523/2020 i datës 01.10.2020 i Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit; E-mailin e datës 07.10.2020 nga ankuesi; Njoftimi për inicim te procedurës disiplinore i datës 01.10.2020 i Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit drejtuar Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës; E-maili i datës 07.10.2020; Vendimi i datës 26.08.2020; Vendimi i datës 25.09.2020; Vendimi i datës 06.06.2006; Vendimi i datës 27.06.2006; Vendimi i datës 17.08.2012; Vendimi i datës 05.08.2015; Vendimi i datës 12.02.2019; Raporti i auditimit për vitin 2018; E -mailin e datës 16.05.2018 nga [REDAKTUAR] për Ilir Morinen; E -mailin e datës 07.02.2019 nga Luan Sabedinaj për [REDAKTUAR] E-mailin e datës 03.08.2020 nga [REDAKTUAR] për [REDAKTUAR]; E-mailin e datës 19.08.2020 nga [REDAKTUAR] për [REDAKTUAR] E-mailin e datës 19.08.2020 nga Ilir Morina për [REDAKTUAR] Formularin me komentet e kryeministri, Zëvendëskryeministrit, Ministrit mbi vlerësimin vjetor të rezultateve në punës të Zyrtarit të Lartë Drejtues i datës 29.05.2020; E-mailin e datës 26.08.2020 nga ankuesi; Vendimin e datës 26.08.2020; E-mailin e datës 19.08.2020 nga [REDAKTUAR]

██████████ E-mailin e datës 30.07.2020 dhe 27.07.2020 nga ██████████ ██████████ për ankuesin; Kërkesën për lejimin e bartjes së lëndës drusore nga prona private e datës 23.07.2020 nga Gani Nikqi; Vendim i datës 29.09.2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendim me Nr. 02/32 i datës 25.09.2020 dhe Nr. 01/32 i datës 25.09.2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Raporti i treguesve mjedisor 2020; Propozim për punë për rend të ditës e datës 07.09.2020; Deklaratë e Pajtueshmërisë me Rregulloren e Punës së Qeverisë nr. 09/2011; Propozim-Vendim; Vendim i datës 06.06.2006 për emërimin e ankuesit Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit; Kontratë e Marrëdhënies së punës e datës 27.06.2006; Vendim i datës 10.06.2009 për vazhdimin e mandatit të Kryeshefit Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit; Vendim i datës 17.08.2012 për vazhdimin e mandatit të Kryeshefit Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit; Vendim i datës 05.08.2015 për vazhdimin e mandatit të Kryeshefit Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit; Vendim i datës 12.02.2019 për vazhdimin e mandatit të Kryeshefit Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit; Raporti final i auditimit për Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës i datës 15.11.2016; Përgjigje në ankesë e datës 23.10.2020, me numër protokolli 2233/2020, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit ██████████ është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës konstaton se ankuesi ██████████ nga data 06.06.2006 është emëruar Kryeshefi Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, ndërsa me Vendimin me numer Nr.04/89 të datës 12.02.2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i është vazhduar mandati edhe 3 vjet në pozitën Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Me Vendimin me numër Nr. 1523/2020 të datës 01.10.2020 të Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit ankuesi është pezulluar nga puna me 50% të pagës, me arsyetim se ka dështuar të përmbushë përgjegjësitë e tij, gjegjësisht ka dështuar të sigurojë zbatimin e rekomandimeve nga raportet e auditimit, ka ushtruar presion të vazhdueshëm ndaj zyrtareve të MEA gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare, si dhe ka treguar neglizhencë gjatë bashkëpunimit me menaxhmentin e MEA.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në kompetencat kushtetuese dhe ligjore për shqyrtimin e ligjshmërisë në shërbimin civil, ka shqyrtuar ligjshmërinë e Vendimit të Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit me numër 1523 të datës 01.10.2020 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore pezullim nga detyra me 50% të pagës deri në marrje të vendimit tjetër. Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se ky vendim nuk është nxjerr në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht me nenin 56 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë sepse në mënyrë taksative janë përcaktuar rastet kur një nëpunës civil pezullohet nga marrëdhënia e punës, sipas detyrës zyrtare.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se ministri nuk është personi kompetent për të bërë pezullimin me 50% të pagës

së nëpunësit civil sepse kjo përgjegjësi është e Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, ka konstatuar se pezullimi i marrëdhënies së punës së nëpunësve civil përcaktohet në bazë të nenit 56 dhe 57 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, qoftë sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të nëpunësit civil, kështu që asnjëra nga dispozitat e nenit 56 dhe 57 të këtij ligji nuk ka përcaktuar që nëpunësit civil mund t'i pezullohet marrëdhënia e punës me 50 % të pagës, ndërsa neni 58 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë parasheh specifikisht se kur nëpunësi përfiton 50% të pagës gjatë pezullimit, kjo përcaktohet vetëm në rastin *"nëse ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, që deklarohet nga vetë nëpunësi, sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e tij në një pozitë tjetër, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji"*, mbi këtë bazë Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë në dispozitat e tij nuk parasheh asnjë rrethanë tjetër të pezullimit të marrëdhënies së punës së nëpunësit civil ku përfiton 50% të pagës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke ju referuar nenit 33 paragrafit 2 nën paragrafin 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendës drejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme"*, konstaton se pozita e ankuesit Kryeshef Ekzekutiv është pozitë e kategorisë së lartë drejtuese, kështu që për çdo supozim të shkeljeve të detyrave të punës procedura mund të fillohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë vetëm në Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë siç parashihet me nenin 49 paragrafin 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 23 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, dhe në asnjë formë të merret vendim për pezullim të marrëdhënies së punës me 50% të pagës. Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit me Vendimin me numër 1523 të datës 01.10.2020 , me te cilin i ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore pezullimin nga detyra me 50% të pagës ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me te cilin përcaktohet se: *... komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar"* sepse në rastin konkret vetëm Komisioni Disiplinor, respektivisht Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë mund të pezulloj nëpunësin civil te nivelit të lartë drejtues për shkelje të detyrave të punës, dhe rrjedhimisht pretendimi i ankuesit se ministri nuk është kompetent për të nxjerr një vendim të tillë është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Vendimi i Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit me numër 1523 të datës 01.10.2020 lidhur me pezullimin nga detyra me 50% të pagës se tij deri në marrje të vendimit tjetër, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafi 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht në pjesën hyrëse të tij nuk është përcaktuar saktë baza ligjore e nxjerrjes së këtij vendimi, në pjesën përmbyllëse nuk është përcaktuar saktë organi se ku pala mund të drejtohet me ankesë kundër këtij akti, si dhe i njëjti vendim nuk është i arsyetuar me gjendje faktike pasi që nuk është arsyetuar se çfarë dëmi ka shkaktuar ankuesi me veprimet e tij, kështu një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij sipas nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Vendimi me Nr. 1523/2020 i datës 01.10.2020 i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit lidhur me pezullimin nga detyra me 50% të pagës së tij deri në marrje të vendimit tjetër, është nxjerr nga organi që nuk ka kompetencë dhe është në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë", rrjedhimisht pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit është i obliguar që ankuesin [REDAKTUAR] ta kthejë në pozitën Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës sipas Vendimit me numër Nr.04/89 të datës 12.02.2019 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e 50% të pagës nga dita e pezullimit deri në zbatimin e këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr.414/2020**

Avdyl BEKTESHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit [REDAKTUAR]
- Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit; dhe
- Arkivat të KPMShCK-së.

